



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

Nr. ____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

Lënda: Kthim përgjigjeje për kërkesën e ardhur elektronikisht në adresën zyrtare më datën 13.01.2026.

QËNDRA “RES PUBLICA”,

Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7

Email: gendra.respublica@gmail.com

Tiranë,

Në përgjigje të kërkesës suaj ardhur në mënyrë elektronike në adresën zyrtare më datën 13.01.2026. *Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit* të Bashkisë Himarë, në bazë të kompetencave që i ngarkon ligji nr.107 datë, 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.894, datë 04.11.2015 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit*”, ju bën me dije për raportin vjetor të inspektimit për periudhën 2025:

1. Veprimtaria inspektuese gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2025, IMT ka ushtruar veprimtarinë e tij përmes kontrolleve në terriotor si rezultat i :

- ankesave të qytetarëve,
- kontrolleve rutinë,
- kërkesave nga institucione të tjera.

Numri total i inspektimeve të kryera :

-Sipas procesverbaleve të konstatimit gjatë vitit 2025 rezultojnë 108 (njëqind e tetë) konstatime ku përfshihen:

- ndërtime pa leje ndërtimi;
- shtesa apo ndërhyrje pa leje;
- mosrespektim i kushteve të lejes së ndërtimit;

- ndryshim destinacioni pa leje përkatëse.

-Sipas vendimeve për gjobë gjatë vitit 2025 rezultojnë 100 (njëqind) masa administrative me gjobë;

- Masat e gjobave janë vendosur me shkallën e shkeljes dhe përsëritjen e saj.

-Sipas vendimeve për prishje të objektit të kundërligjshëm rezultojnë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vendime për prishje si :

- prishje vullnetare;
- prishje nga IMT;
- Ndertime që kanë qenë ndërtime pa leje ose struktura të përkohshme.

2. Bashkëpunim institucional :

Gjatë vitit 2025 IMT ka bashkëpunuar me :

- Policinë e Shtetit ;
- strukturat e bashkisë;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Strukturat e AZHT-së;
- Institucione të tjera, sipas rasteve konkrete.

Ky bashkëpunim ka ndihmuar në zbatimin e ligjit dhe rruajtjen e territorit.

3. Problematikat e konstatuara,

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë janë evidentuar disa vështirësi, si:

- Mungesa e burimeve njerëzore ;
- Vështirësi në ekzekutimin e vendimeve për prishje;
- Rezistenca nga subjektet shkelëse;
- Zvarritje procedurale në disa raste.

-Duke qenë se ky Inspektorat ka qenë në ndryshime të vazhdueshme dhe largime të stafëve inspektuese gjatë vitit 2025, ka qenë në proces ristrukturimi si Inspektorat i Mbrojtjes së Territorit.

Përfundime

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2025 ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kontribuar në mbrojtjen e territorit dhe parandalimin e ndërtimeve të paligjshme.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË
Vangjel Tavo

NË MUNGESË, ME URDHËR DHE ME DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI
Erifili Berberi